VENDIM
Nr. 552, datë 31.7.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK "PËR PËRPUTHSHMËRINË ELEKTROMAGNETIKE TË PAJISJEVE DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilëve janë përshirë në listën bashkëlidhur këtij vendimi, shërbejnë si dokumente referencë për prezumimin e konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike të pajisjeve me kërkesat thelbësore të objektivave të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Çdo pajisje e vendosur në treg, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe në përputhje me vendimin nr. 1054, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"", nuk do të pengohet që të bëhet e disponueshme në treg, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Edhe certifikatat e lëshuara në përputhje me vendimin nr. 1054, datë 23.12.20015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"", janë të vlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Vendimi nr. 1054, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"", shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

[1] *Ky vendim është përafruar pjesërisht me direktivën 2014/30/EU, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, "Për harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me përputhshmërinë elektromagnetike".*
Numri CELEX 32014L0030, Numri i "Fletores zyrtare" l 96/79.

RREGULLI TEKNIK
PËR PËRPUTHSHMËRINË ELEKTROMAGNETIKE DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Ky rregull teknik (këtu e në vijim referuar si: "Rregull") përcakton rregullat për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe ka për qëllim të sigurojë funksionimin e tregut, duke kërkuar që pajisja të respektojë nivelin e duhur të përputhshmërisë elektromagnetike.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky rregull zbatohet për pajisjet e përcaktuara në nenin 3, të këtij rregulli.
2. Ky rregull nuk zbatohet për:
a) pajisjet që bien në fushën e zbatimit të rregullit teknik për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve;
b) produktet, pjesët dhe aplikimet aeronautike;
c) pajisjet radio të përdorura nga radioamatorët, nëse pajisjet nuk janë bërë të disponueshme në treg. Pjesët përbërëse që montohen nga radioamatorët dhe pajisjet tregtare të modifikuara dhe të përdorura nga radioamatorët nuk konsiderohen pajisje të disponueshme për treg;
ç) pajisje, natyra e karakteristikave fizike e të cilave është e tillë që:
i) të mos gjenerojnë ose kontribuojnë në emetime elektromagnetike që tejkalojnë nivelin e lejuar për pajisjet radio dhe telekomunikacion gjatë funksionimit, sipas qëllimit të paracaktuar; dhe
ii) të funksionojnë normalisht sipas qëllimit të paracaktuar të përdorimit dhe të mos përkeqësohet në mënyrë të papranueshme në prani të ndërhyrjes elektromagnetike.
3. Nëse për pajisjen e përmendur në pikën 1, të këtij neni, kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, parashikohen pjesërisht ose plotësisht në mënyrë specifike me legjislacion tjetër, ky rregull nuk zbatohet, ose pushon së zbatuari, për ato pajisje në lidhje me këto kërkesa, nga data e zbatimit të legjislacionit specifik.
4. Ky rregull nuk ndikon në zbatimin e legjislacionit që rregullon sigurinë e pajisjeve.

Neni 3
Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij rregulli teknik, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:
1. "Pajisje", çdo aparat ose instalim i palëvizshëm.
2. "Aparat", çdo mekanizëm përfundimtar ose kombinim i tyre që bëhet i disponueshëm në treg si njësi e vetme funksionale, i destinuar për përdoruesin e fundit dhe që prodhon çrregullime elektromagnetike ose funksionimi i të cilit ndikohet nga këto çrregullime.
3. "Instalim i palëvizshëm", kombinimi i veçantë i disa tipa aparatesh dhe, sipas rastit, mekanizmave të tjerë, të montuar, të instaluar dhe të destinuar për t'u përdorur në mënyrë të përhershme në një vend të paracaktuar.
4. "Përputhshmëri elektromagnetike", aftësia e pajisjes për të funksionuar në mënyrë të kënaqshme në mjedisin e saj elektromagnetik, pa shkaktuar ndërhyrje elektromagnetike të patolerueshme te pajisja tjetër në atë mjedis.

5. “çrregullim elektromagnetik”, çdo fenomen elektromagnetik që mund të prishë performancën e pajisjes. Një çrregullim elektromagnetik mund të jetë zhurmë elektromagnetike, sinjal i padëshiruar ose ndryshim në vetë mediumin transmetues.

6. “Imunitet”, aftësia e pajisjes që të funksionojë sipas qëllimit të paracaktuar, pa dëmtuar efektshmërinë e saj në prezencë të një çrregullimi elektromagnetik.

7. “Qëllime të sigurisë”, qëllime në lidhje me masat mbrojtëse të jetës njerëzore dhe të pronës.

8. “Mjedis elektromagnetik”, të gjitha fenomenet elektromagnetike të vëzhgueshme në një zonë të caktuar.

9. “Bërje e disponueshme në treg”, çdo furnizim i aparatit për shpërndarje, konsumim ose përdorim në tregun shqiptar gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

10. “Vendosje në treg”, bërja e disponueshme për herë të parë e aparatit në tregun e Republikës së Shqipërisë.

11. “Prodhues”, çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një aparat ose ka një aparat të projektuar a të prodhuar dhe e tregton këtë aparat nën emrin apo markën e tij tregtare.

12. “Përfaqësues i autorizuar”, çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili ka një akt përfaqësimi nga prodhuesi për të vepruar në emër të tij për detyra specifike të përmenduara në këtë rregull.

13. “Importues”, çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që vendos një aparat nga një vend i tretë në tregun shqiptar.

14. “Shpërndarës”, çdo person fizik ose juridik, i përfshirë në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit, që bën të disponueshëm në treg aparatin.

15. “Operator ekonomik”, prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi dhe shpërndarësi.

16. “Specifikim teknik”, dokumenti, ku përshkruhen kërkesat teknike që duhet të përmbushen nga një pajisje.

17. “Standard i harmonizuar shqiptar”, një standard shqiptar, që transpozon një standard të harmonizuar evropian, në mbështetje të këtij rregulli, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, në bashkërendim me ministritë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në “Fletoren zyrtare”.

18. “Akreditimi”, është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

19. “Organizëm kombëtar i akreditimit”, organi sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin.

20. “Vlerësim i komformitetit”, procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat thelbësore të këtij rregulli, për një aparat.

21. “Organ i vlerësimit të konformitetit”, çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

22. “Kthim i produktit”, çdo masë për kthimin mbrapsht të një aparati që është bërë ndërkohë i disponueshëm te përdoruesi i fundit.

23. “Ndalim i tregtimit”, çdo masë që parandalon bërjen të disponueshëm në treg të aparatit në zinxhirin e furnizimit.

24. “Markim CE”, markimi me të cilin prodhuesi tregon se pajisjet elektrike janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

25. “Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut”, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

2. Për qëllime të këtij rregulli, konsiderohen aparate:

a) “Elementi përbërës” ose “Nënmontimi”, i destinuar të përfshihet në një aparat nga përdoruesi i fundit, dhe që mund të prodhojë çrregullime elektromagnetike ose funksionimi i të cilave rrezikon të ndikohet prej tyre.

b) “Instalimi i lëvizshëm”, i përcaktuar si kombinim i aparateve dhe, sipas rastit, mekanizmave të tjerë, të destinuar që të lëvizen dhe të funksionojnë në vendndodhje të ndryshme.

Neni 4
Bërja e disponueshme në treg dhe/ose vënia në shërbim

Pajisja bëhet e disponueshme në tregun shqiptar dhe/ose vihet në shërbim, vetëm nëse është në përputhje me këtë rregull, kur instalohet siç duhet, mirëmbahet dhe përdoret për qëllimin që është destinuar.

Neni 5
Lëvizja e lirë e pajisjes

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk ndalohet, për arsye që lidhen me përputhshmërinë elektromagnetike, bërja e disponueshme në treg dhe/ose vënia në shërbim e pajisjes që është në përputhje me këtë rregull.

2. Kërkesat e këtij rregulli nuk pengojnë zbatimin e masave specifike të mëposhtme, që kanë të bëjnë me vënien në shërbim ose përdorimin e pajisjes, të tilla si:

a) masat për të tejkaluar një problem ekzistues ose të parashikuar të përputhshmërisë elektromagnetike në një mjedis të caktuar;

b) masat e marra për arsye sigurie për të mbrojtur rrjetet publike të telekomunikacionit apo stacione marrëse ose transmetuese, kur përdoren për qëllime sigurie, në situata me spektër të mirëpërcaktuar.

3. Masat e marra në pikën 2, të këtij neni, duhet t’i njoftohen menjëherë ministrisë përgjegjëse për tregtinë, duke dhënë detaje për llojin e masës, kohëzgjatjen dhe arsyet që justifikojnë marrjen e saj.

4. Ministria përgjegjëse për tregtinë jep opinion për masat e marra.

5. Pikat 3 dhe 4, të këtij neni, zbatohen pa cenuar parashikimet e legjislacionit në fuqi për procedurën e njoftimit në fushën e standardeve teknike dhe të rregulloreve.

6. Pajisjet që nuk janë në përputhje me këtë rregull mund të paraqiten ose demonstrohen në panaire, ekspozita ose ngjarje të ngjashme, me kushtin që një shenjë e dukshme të tregojë qartë se pajisja nuk duhet të vendoset në treg ose të vihet në përdorim derisa të sillet në përputhje me kërkesat e këtij rregulli. Demonstrimi duhet të bëhet vetëm nëse merren masat e duhura për të shmangur çrregullimet elektromagnetike.

Neni 6
Kërkesat thelbësore

Pajisja duhet të përmbushë kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, (këtu e në vijim referuar si: “Kërkesat thelbësore”).

KREU II
DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Neni 7
Detyrimet e prodhuesit

1. Kur prodhuesi vendos aparatet në treg, siguron se ato janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në shtojcën I.

2. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik të referuar në shtojcat II ose III dhe kryen procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas parashikimeve të nenit 14, të këtij rregulli, ose kërkon kryerjen e saj.

3. Kur nga procedura e vlerësimit të konformitetit është demonstruar përputhshmëria e aparatit me kërkesat e zbatueshme, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit dhe fikson markimin CE.

4. Prodhuesi mban dokumentacionin teknik dhe deklaratën EU të konformitetit për 10 vjet pasi aparatet janë vendosur në treg.

5. Prodhuesi siguron se zbatohen procedurat e nevojshme që prodhimi në seri të mbetet në konformitet me këtë rregull. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e aparateve, dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara shqiptare, standardet ndërkombëtare ose kombëtare ose në specifikimet e tjera teknike, sipas të cilave është deklaruar konformiteti i aparateve, duhet të merren në konsideratë.

6. Prodhuesi siguron që aparatet e vendosura në treg prej tij të kenë të shënuar tipin, numrin serial ose një element tjetër që mundëson identifikimin e tij, ose kur madhësia dhe natyra e aparatit nuk e mundëson atë, informacioni i kërkuar vendoset në paketimin ose në dokumentet shoqëruese të aparatit.

7. Prodhuesi vendos në aparat emrin e tij, emrin e regjistruar tregtar ose markën tregtare dhe adresën postare në të cilën mund të kontaktohet ose, kur ky informacion nuk është i mundur të vendoset në pajisje, prodhuesi i vendos ato në paketimin ose dokumentet shoqëruese të tij. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme në të cilën mund të kontaktohet prodhuesi. Informacioni për adresën duhet të jenë në gjuhën shqipe ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

8. Prodhuesi siguron që aparati të shoqërohet nga udhëzime për përdorimin dhe nga informacioni i parashikuar në nenin 18, në gjuhën shqipe. Udhëzuesit dhe informacionet, si dhe etiketimi, duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe lehtësisht të kuptueshme.

9. Prodhuesi që konsideron ose ka arsye për të besuar se aparati që ka vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë rregull, duhet që menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë aparatin në përputhshmëri, ose sipas rastit, të ndalojë tregtimin apo ta kthejë atë nga tregu. Kur aparati paraqet rrezik, prodhuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke i dhënë hollësitë, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

10. Prodhuesi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, siguron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose formë elektronike, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për të demonstruar përputhshmërinë e aparatit me këtë rregull. Prodhuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga aparati i vendosur në treg prej tij.

Neni 8

Përfaqësuesi i autorizuar

1. Prodhuesi, me një akt përfaqësimi, mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 7, të këtij rregulli, dhe detyrimi për të hartuar dokumentacionin teknik të referuar në pikën 2, të nenit 7, të këtij rregulli, nuk mund të jenë pjesë e aktit të përfaqësimit.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar:

a) të mbajë deklaratën EU të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion strukturës së mbikëqyrjes së tregut për 10 vjet, pas vendosjes në treg të aparatit;

b) t'i sigurojë strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, rast të një kërkese të arsyetuar nga asaj, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për demonstrimin e përputhshmërisë së aparatit; dhe

c) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas kërkesës të bërë nga ana e saj, për marrjen e masave për eliminimin e rreziqeve të shfaqura nga aparati, për të cilin i është lëshuar akti i përfaqësimit.

Neni 9
Detyrimet e importuesit

1. Importuesi vendos në tregun shqiptar vetëm aparate në përputhje me këtë rregull dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

2. Para vendosjes së pajisjeve elektrike në treg, importuesi sigurohet që:

a) prodhuesi ka kryer procedurën e vlerësimit të konformitetit të përmendur nenin 14, të këtij rregulli, dhe ka përgatitur dokumentacionin teknik;

b) aparati të ketë markimin CE dhe të shoqërohet me dokumentet e kërkuara; dhe se

c) prodhuesi ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 7, të këtij rregulli.

3. Kur importuesi konsideron ose ka arsye të besojë se aparati që ai importon nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore, ai nuk duhet ta vendosë në treg derisa ta sjellë në konformitet. Kur aparati paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Importuesi vendos në aparat emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare ku mund të kontaktohet ose, kur ky informacion nuk është e mundur të vendoset në aparat, importuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të tij. Të dhënat mbi adresën duhet të jenë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

5. Importuesi siguron që aparati të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin ose, sipas rastit, udhëzimet për mirëmbajtjen, si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe. Udhëzuesit dhe informacioni i sigurisë, si dhe çdo etiketim tjetër duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe lehtësisht të kuptueshme.

6. Importuesi siguron që gjatë kohës që aparati është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të këtij rregulli.

7. Importuesi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se aparati, të cilin ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull, duhet menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë atë në konformitet, ose sipas rastit, të ndalojë tregtimin apo ta kthejë atë nga tregu. Kur aparati shfaq një rrezik, importuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

8. Importuesi mban, deri në 10 vjet pas vendosjes së aparatit në treg, një kopje të deklaratës EU të konformitetit dhe të dokumentacionit teknik dhe siguron që t'i vërë ato në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas kërkesës.

9. Importuesi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose në formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të aparatit në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këto struktura. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja elektrike e vendosur në treg prej tij.

Neni 10
Detyrimet e shpërndarësit

1. Kur apartet bëhen të disponueshme në treg, shpërndarësi duhet të veprojë me kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e kërkesave të këtij rregulli.

2. Para bërjes së disponueshme në treg të pajisjes elektrike, shpërndarësi verifikon që:

a) aparati mban markimin CE;

b) aparati shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar, udhëzimet dhe informacionin për sigurinë në gjuhën shqipe;

c) prodhuesi dhe importuesi kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në nenet 7, pikat 5 e 6, dhe 9, pika 4, të këtij rregulli.

3. Kur shpërndarësi konsideron ose ka arsye për të besuar se aparati nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore, ai nuk duhet ta bëjë të disponueshëm në treg aparatin, derisa ai të sillet në konformitet. Kur aparati shfaq rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin për rrezikun, si dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Shpërndarësi siguron se gjatë kohës kur aparati është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli.

5. Shpërndarësi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se aparati, të cilin ai e ka bërë të disponueshëm në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull, siguron, nëse është e nevojshme, marrjen e masave korrigjuese për sjelljen e tij në përputhshmëri me kërkesat e këtij rregulli ose, sipas rastit, ndalimin e tregtimit apo kthimin e saj. Kur aparati paraqet rrezik, shpërndarësi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

6. Shpërndarësi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose në formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të aparatit. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga aparatet e vendosura në treg prej tij.

Neni 11

Rastet ku detyrimet e prodhuesit zbatohen për importuesin dhe shpërndarësin

Importuesi ose shpërndarësi konsiderohet prodhues për qëllime të këtij rregulli dhe i nënshtrohet detyrimeve të prodhuesit sipas nenit 7, të këtij rregulli, kur ai vendos një aparat në treg nën emrin ose markën e tij tregtare ose e modifikon aparatin e vendosur tashmë në treg në mënyrë të tillë që të ndikojë në përputhshmërinë e saj me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 12

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, sipas kërkesës së strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut identifikojnë:

a) çdo operator ekonomik i cili i ka furnizuar ata me aparate;

b) çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me apararte.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, për 10 vjet pasi janë furnizuar me aparatin dhe për 10 vjet pasi kanë furnizuar aparatin.

KREU III

KONFORMITETI I PAJISJES

Neni 13

Prezumimi i konformitetit të pajisjes

Pajisja që është në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, prezumohet se janë në përputhje me me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli, të mbuluara nga ato standarde ose pjesë të tyre.

Neni 14

Procedurat e vlerësimit të konformitetit për aparatin

1. Vlerësimi i konformitetit të aparatit me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli mund të përcaktohet me secilën nga procedurat e vlerësimit të konformitetit të mëposhtme, të përzgjedhura nga prodhuesi:

a) kontrolli i brendshëm i prodhimit i përcaktuar në shtojcën II;

b) ekzaminimi i tipit EU, i cili pasohet nga konformiteti i tipit të bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit, i përcaktuar në shtojcën III.

2. Prodhuesi mund të vendosë të kufizojë zbatimin e procedurës së përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, për disa aspekte të kërkesave thelbësore, me kusht që për aspektet e tjera të kërkesave thelbësore të zbatohet procedura e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të po këtij neni.

Neni 15

Deklarata e EU e konformitetit

1. Deklarata EU e konformitetit provon se është demonstruar përmbushja e kërkesave thelbësore të përcaktuara në shtojcën I.

2. Deklarata EU e konformitetit hartohet sipas formës së përcaktuar në shtojcën IV. Ajo përmban elementet e specifikuara në modulet përkatëse të shtojcave II dhe III, të këtij rregulli, dhe përditësohet vazhdimisht. Deklarata EU e konformitetit përkthehet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të kërkuar nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

3. Kur aparati është objekt i zbatimit të më shumë se një akti ligjor apo nënligjor që kërkon hartimin e deklaratës EU të konformitetit, për të gjitha aktet hartohet një deklaratë e vetme konformiteti. Deklarata duhet të përmbajë identifikimin e akteve ligjore të zbatueshme, duke përfshirë referencat e tyre të botimit.

4. Me hartimin e deklaratës EU të konformitetit, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e aparatit me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 16

Parimet e përgjithshme të markimit CE

Markimi CE i nënshtrohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 17

Rregullat dhe kushtet për vendosjen e markimit CE

1. Markimi CE vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme tek aparati ose në pllakën të dhënave të tij. Kur kjo nuk është e mundur ose nuk garantohet për shkak të natyrës së aparatit, ajo vendoset te paketimi dhe te dokumentet shoqëruese.

2. Markimi CE vendoset përpara se aparati të vendoset në treg.

3. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në bashkëpunim me autoritetet doganore, siguron aplikimin korrekt të regjimit që rregullon markimin CE dhe ndërmerr veprimet e duhura në rast të përdorimit të papërshtatshëm të këtij markimi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 18

Informacion në lidhje me përdorimin e aparatit

1. Aparati duhet të shoqërohet me informacion për çdo masë paraprake specifike që merret për të montuar, instaluar, mirëmbajtur ose përdorur aparatin, me qëllim që të sigurohet që, kur të vihet në shërbim, ai të jetë në përputhje me kërkesat thelbësore.

2. Aparati, për të cilin përputhshmëria me kërkesat thelbësore nuk sigurohet për zonat e banuara, shoqërohet nga një pasqyrim i qartë i këtij kufizimi në përdorim dhe, sipas rastit, edhe në paketim.

3. Informacioni i kërkuar për të mundësuar përdorimin e aparatit në përputhje me qëllimin e përcaktuar përfshihet në udhëzimet që e shoqërojnë atë.

Neni 19

Instalimet e palëvizshme

1. Aparati që është bërë i disponueshëm në treg dhe që mund të inkorporohet në një instalim të palëvizshëm i nënshtrohet dispozitave përkatëse për aparatet, të parashikuara në këtë rregull.

2. Kërkesat e neneve 6 deri në 12 dhe 14 deri në 18, të këtij rregulli, nuk janë detyruese në rastin e aparateve të destinuara për t'u inkorporuar në një instalim të palëvizshëm të përcaktuar dhe që nuk janë bërë të disponueshëm në treg.

Në raste të tilla, dokumentacioni shoqërues identifikon instalimin e palëvizshëm dhe karakteristikat e tij që lidhen me përputhshmërinë elektromagnetike dhe tregon masat paraprake që duhen marrë për inkorporimin e aparatit në instalimin e palëvizshëm, me qëllim që të ruhet përputhshmëria e atij instalimi me këtë rregull. Dokumentacioni përfshin, gjithashtu, dhe informacionin e përmendur në nenet 7, pikat 6 e 7, dhe 9, pika 4, të këtij rregulli.

3. Praktikat e mira inxhinerike të përmendura në pikën 2, të shtojcës I, të këtij rregulli, dokumentohen dhe dokumentacioni mbahet nga personi ose personat përgjegjës në dispozicion të strukturës së mbikëqyrjes së tregut për inspektim, për sa kohë që instalimi i palëvizshëm është në funksionim.

4. Kur ka tregues të mospërputhshmërisë së instalimit të palëvizshëm, sidomos nëse ka ankesa për ndërhyrjet/çrregullimet elektromagnetike që gjenerohen nga instalimi, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut mund të kërkojë prova të përputhshmërisë së instalimit të palëvizshëm, dhe nëse është e nevojshme, fillimin e një vlerësimi.

5. Kur mospërputhshmëria provohet, strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut urdhërojnë personin përgjegjës për instalimin për marrjen e masave të duhura për ta sjellë instalimin e palëvizshëm në përputhje me kërkesat thelbësore.

6. Struktura përgjegjëse per mbikëqyrjen e tregut përcakton mënyrën e identifikimit të personit ose të personave përgjegjës për bërjen/arritjen e përputhshmërisë së një instalimi të palëvizshëm me kërkesat thelbësore.

KREU IV

MIRATIMI I ORGANIT TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Neni 20

Autoriteti përgjegjës për miratimin e organit të vlerësimit të konformitetit

1. Ministri përgjegjës për tregtinë vepron si autoritet miratimi për organet e vlerësimit të konformitetit, në kuptim të këtij rregulli, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. Në parashikimet në vijim të këtij rregulli, termi "organ" nënkupton një organizëm të notifikuar evropian të miratuar ose një organ të miratuar shqiptar, të miratuar sipas pikës 1, të këtij neni, për çdo rast.

3. Ministri përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, vepron si autoritet miratues, i ngarkuar me detyrë për krijimin dhe realizimin e procedurave të nevojshme për vlerësimin dhe njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe monitorimin e organeve të miratuara, përfshirë pajtueshmërinë me nenin 24, të këtij rregulli.

Neni 21

Detyrimi për informacion mbi organet e miratuara (OM)

Ministria përgjegjëse për tregtinë publikon në faqen zyrtare të internetit dhe mban të përditësuar listën e organeve të miratuara me numrat e tyre të identifikimit, fushat për të cilat janë miratuar, periudhën e vlefshmërisë dhe çdo ndryshim të tyre.

Neni 22

Kërkesat për organet e miratuara

1. Për qëllim miratimi, një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në pikat 2 deri në 11, të këtij neni.

2. Organi i vlerësimit të konformitetit krijohet dhe ka personalitet juridik sipas legjislacionit në fuqi.

3. Organi i vlerësimit të konformitetit është një organ palë e tretë e pavarur nga organizata ose aparati që vlerëson.

Organi që i përket një shoqate biznesi ose federate profesionale që përfaqëson sipërmarrjet e përfshira në projektim, prodhim, ofrim, montim, përdorim ose mirëmbajtje të aparateve që vlerëson, mund të konsiderohet një organ i tillë, me kusht që të tregohet pavarësia dhe mungesa e një konflikti interesi.

4. Organi i vlerësimit të konformitetit, niveli i tij drejtues dhe stafi përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit nuk do të jetë projektuesi, prodhuesi, furnizuesi, instaluesi, blerësi, pronari, përdoruesi ose mirëmbajtësi i aparateve që ata vlerësojnë, as përfaqësuesi i njërës prej këtyre palëve. Kjo nuk pengon përdorimin e aparateve të vlerësuara që janë të nevojshme për veprimtaritë e organit të vlerësimit të konformitetit ose të përdorimit të këtyre aparateve për qëllime personale.

Organi i vlerësimit të konformitetit, niveli i tij drejtues dhe stafi përgjegjës për të kryer detyra të vlerësimit të konformitetit nuk përfshihen direkt në projektimin, prodhimin ose ndërtimin, tregtimin, instalimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e këtyre aparateve ose nuk përfaqëson palët e përfshira në këto veprimtari. Ata nuk përfshihen në veprimtari që mund të jetë në konflikt me pavarësinë e gjykimit të tyre ose integritetin në lidhje me veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit për të cilat janë miratuar. Kjo vlen në veçanti për shërbimet e konsulencës.

Organet e vlerësimit të konformitetit sigurohen që veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tyre të mos prekin konfidencialitetin, objektivitetin ose paanshmërinë e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit.

5. Organet e vlerësimit të konformitetit dhe stafi i tyre kryejnë veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencën e kërkuar teknike në fushën specifike dhe çlirohen nga çdo presion dhe shtysë, sidomos financiare, që mund të ndikojë gjykimin e tyre ose rezultatet e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit, sidomos në lidhje me personat ose grupet e personave që kanë interes në rezultatet e këtyre veprimtarive.

6. Organi i vlerësimit të konformitetit është i aftë të kryejë të gjitha detyrat e vlerësimit të konformitetit që i caktohen nga shtojca III dhe në lidhje me të cilat është miratuar.

Gjithmonë dhe për çdo procedurë të vlerësimit të konformitetit dhe çdo lloj ose kategori të aparateve në lidhje me të cilat është miratuar, organi i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë në dispozicion:

a) stafin e nevojshëm me njohuri teknike dhe përvojë të mjaftueshme dhe të duhur për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit;

b) përshkrimet e procedurave në përputhje me të cilat është kryer vlerësimi i konformitetit, duke siguruar transparencën dhe aftësinë e riprodhimit të këtyre procedurave. Ai duhet të ketë të përcaktuara politika dhe procedura të duhura që dallojnë ndërmjet detyrave që kryen si organ i miratuar dhe veprimtarive të tjera;

c) procedurat e nevojshme për kryerjen e veprimtarive që marrin parasysh madhësinë e një sipërmarrjeje, sektorin ku vepron, strukturën, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së aparatit në fjalë dhe masën ose natyrën seri të procesit të prodhimit.

Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë të gjitha mjetet e nevojshme për të kryer detyrat teknike dhe administrative që lidhen me veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit në mënyrën e duhur dhe ka akses në të gjitha pajisjet ose shërbimet e nevojshme.

7. Stafi përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit duhet të ketë, si më poshtë vijon:

a) Trajnim të qëndrueshëm teknik dhe profesional që mbulon të gjitha veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, në lidhje me të cilat është miratuar organi i vlerësimit të konformitetit;

b) Njohuri të kënaqshme për kërkesat e vlerësimeve që kryejnë dhe autoritet të mjaftueshëm për të kryer këto vlerësime;

c) Njohuri të mjaftueshme dhe aftësi për të kuptuar kërkesat thelbësore, standardet e harmonizuara të zbatueshme dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit evropian dhe të legjislacionit kombëtar;

ç) Aftësi për të hartuar certifikata, të dhëna dhe raporte që tregojnë se vlerësimi është kryer.

8. Garantohet paanshmëria e organeve të vlerësimit të konformitetit, të nivelit të lartë drejtues të tyre dhe të stafit përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit.

Shpërblimi i nivelit të lartë drejtues dhe stafit përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit të një organi vlerësimi të konformitetit nuk varet nga numri i vlerësimeve të kryera apo nga rezultatet e këtyre vlerësimeve.

9. Organet e vlerësimit të konformitetit përdorin mbulimin me siguracion, përveçse kur ky mbulohet nga ministria përgjegjëse për tregtinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose vetë ministria është direkt përgjegjëse për vlerësimin e konformitetit.

10. Stafi i një organi vlerësimi të konformitetit respekton sekretin profesional në lidhje me të gjithë informacionin e marrë për të kryer detyrat e tyre, sipas aneksit III ose çdo dispozitë të legjislacionit kombëtar që i jep fuqi, përveçse në lidhje me autoritetet kompetente ku kryhen veprimtaritë e tij. Të drejtat e pronësisë mbrohen.

11. Organet e vlerësimit të konformitetit marrin pjesë ose sigurohen që stafi i tyre përgjegjës, për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit, të informohet për veprimtaritë përkatëse të standardizimit.

Neni 23

Prezumimi i konformitetit të organeve të miratuara

Kur organi i vlerësimit të konformitetit plotëson kriteret e përcaktuara në standardet shqiptare të harmonizuara ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në "Fletoren zyrtare" do të prezumohet se është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 22, të këtij rregulli, për sa kohë që standardet e aplikueshme të harmonizuara i mbulojnë këto kërkesa.

Neni 24

Degët dhe nënkontraktimi nga organet e miratuara

1. Kur një organ nënkontrakton detyra specifike që lidhen me vlerësimin e konformitetit ose i drejtohet një dege të saj për kryerjen e tyre, ai duhet të sigurojë që nënkontraktori ose dega të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 22, të këtij rregulli, dhe duhet të informojë autoritetin miratues përkatësisht.

2. Organet e miratuara marrin përgjegjësi të plotë për detyrat e kryera nga nënkontraktorët ose degët e tyre, kudo që ato janë themeluar.

3. Aktivitetet mund të nënkontraktohen ose të kryhen nga një degë vetëm me marrëveshje me klientin.

4. Organet e miratuara duhet të mbajnë në dispozicion të autoritetit miratues dokumentet përkatëse në lidhje me vlerësimin e kualifikimeve të nënkontraktuesit ose degës dhe punën e kryer nga ata në shtojcën III.

Neni 25
Aplikimi për miratim

Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të paraqesë një kërkesë për miratim tek autoriteti miratues, në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 26
Ndryshimet në miratim

1. Kur ministri përgjegjës ka dyshime ose informohet se një organ i miratuar nuk i përmbush më kërkesat e miratimit, ose nuk përmbush më detyrimet e tij, atëherë ai, sipas rastit, dhe në varësi të shkallës së mospërmbushjes së kërkesave ose detyrimeve, pezullon ose anulon miratimin.
2. Në rast pezullimi ose anulimi të miratimit, ose kur organi i miratuar ka pushuar veprimtarinë e tij, ministri përgjegjës merr masat e duhura për të siguruar që dosjet t'i kalojnë një organi tjetër të miratuar ose, sipas rastit, të mbahen në dispozicion të ministrit ose strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.
3. Në rastin kur ministri përgjegjës anulon miratimin, emri i organit të vlerësimit të konformitetit hiqet nga Regjistri Kombëtar i Organeve të Miratuara.

Neni 27
Detyrimet operacionale të organeve të miratuara

1. Organet e miratuara duhet të kryejnë vlerësimet e konformitetit, në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit të parashikuara në shtojcën III.
2. Vlerësimet e konformitetit duhet të kryhen në mënyrë proporcionale, duke shmangur ngarkesat e panevojshme për operatorët ekonomikë. Organet e vlerësimit të konformitetit kryejnë aktivitetet e tyre duke marrë parasysh madhësinë e një ndërmarrjeje, sektorin në të cilin vepron, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së aparatit në fjalë dhe natyrën masive ose serike të procesit të prodhimit.
Duke vepruar kështu, ata megjithatë do të respektojnë shkallën e ashpërsisë dhe nivelin e mbrojtjes të kërkuar për pajtueshmërinë e aparatit me këtë rregull teknik.
3. Kur një organ i miratuar zbulon se kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I ose standardet përkatëse shqiptare të harmonizuara ose specifikimet e tjera teknike nuk janë plotësuar nga një prodhues, ai duhet të kërkojë që prodhuesi të marrë masat e duhura korrigjuese dhe nuk i lëshon certifikatën e konformitetit.
4. Kur, gjatë monitorimit të konformitetit pas lëshimit të certifikatës, një organ i miratuar konstaton se një aparat nuk është më në përputhje me kërkesat, ai duhet të kërkojë nga prodhuesi të marrë masat e duhura korrigjuese dhe duhet të pezullojë ose tërheqë certifikatën nëse është e nevojshme.
5. Kur nuk ndërmerren masa korrigjuese ose ato nuk kanë efektin e kërkuar, organi duhet të kufizojë, të pezullojë ose të tërheqë certifikatat, sipas rastit.

Neni 28
Ankimi kundër vendimeve të organeve të njoftuara

Organet e miratura duhet të kenë të rregulluar procedurën e ankimimit ndaj vendimeve të tyre. Organi i miratuar informon ministrinë në lidhje me çfarëdolloj ankesë të pranuar dhe mënyrën se si ajo është zgjidhur.

Neni 29

Detyrim i informacionit nga organet e miratuara

1. Organet e miratuara duhet të informojnë autoritetin miratues për sa më poshtë:

a) Çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje të një certifikate;

b) Çdo rrethanë që ndikon në fushëveprimin ose kushtet e miratimit;

c) Sipas kërkesës, aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të kryera brenda fushës për të cilën janë miratuar dhe çdo aktiviteti tjetër të kryer, duke përfshirë aktivitetet ndërkufitare dhe nënkontraktimin.

2. Organet e miratuara duhet të sigurojnë organet e tjera të miratuara sipas këtij rregulli teknik, që kryejnë aktivitete të ngjashme të vlerësimit të konformitetit që mbulojnë të njëjtat aparate, me informata relevante për çështjet që kanë të bëjnë me rezultatet negative dhe, sipas kërkesës, të vlerësimit pozitiv të vlerësimit të konformitetit.

KREU V

MBIKËQYRJA E TREGUT DHE KONTROLLI I APARATEVE QË HYJNË NË TREG

Neni 30

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i aparateve që hyjnë në treg

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i aparateve që hyjnë në treg bëhet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore dhe për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore.

Neni 31

Procedura për trajtimin e aparateve që paraqesin rrezik në nivel kombëtar

1. Nëse struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut ka arsye të mjaftueshme për të besuar që një aparat paraqet rrezik për aspektet e mbrojtjes së interesit publik, kryen një vlerësim të përputhjes së aparati në fjalë me kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë rregull. Operatorët përkatës ekonomikë bashkëpunojnë, sipas nevojës, me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për këtë qëllim.

2. Kur gjatë vlerësimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut konstaton se pajisja nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë rregull, pa vonesë ata i kërkojnë operatorit ekonomik përkatës, që të marrë masat e duhura korrigjuese për ta sjellë aparatin në përputhje me këto kërkesa, për të ndaluar tregtimin, ose për ta kthyer brenda një kohe të arsyeshme, në raport me natyrën e riskut.

3. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut informon për çdo rast ministrin përgjegjës për tregtinë.

4. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut siguron se marrja e masave të referuara në pikën 2, të këtij neni, bazohet në parashikimet ligjore për masat kufizuese, siç përcaktohet në legjislacionin specifik për tregtimin dhe mbikëqyrjen e produkteve joushqimore.

5. Operatori ekonomik siguron marrjen e të gjitha masave të duhura korrigjuese në lidhje me aparatet që kanë bërë të disponueshëm në treg.

6. Kur operatori ekonomik nuk merr masat e duhura korrigjuese, brenda periudhës së referuar në pikën 2, të këtij neni, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr masat e duhura të përkohshme për të ndaluar ose kufizuar bërjen e disponueshme të aparatit në treg, për të ndaluar tregtimin ose për ta kthyer atë.

Neni 32
Mospërputhja formale

1. Pa përjashtuar parashikimet e nenit 31, të këtij rregulli, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut i kërkon operatorit përkatës ekonomik t'i japë fund mospërputhjes në fjalë kur konstaton një nga rastet e mëposhtme:

a) Markimi CE është fiksuar në shkelje të nenit 7, pikat 2, 3 dhe 4, të këtij rregulli;

b) Markimi CE nuk është fiksuar;

c) Deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar;

ç) Deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar me saktësi;

d) Dokumentacioni teknik ose nuk është në dispozicion ose nuk është i plotë;

dh) Informacioni i përmendur në nenin 7, pika 7, ose nenin 9, pika 4, mungon, është i rremë ose i paplotë;

e) Çdo kërkesë tjetër administrative e parashikuar në nenet 7 ose 9 nuk është përmbushur.

2. Kur mospërputhja formale vazhdon, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose për të parandaluar bërjen të disponueshme të aparatit në treg ose siguron që të ndalohet tregtimi apo të kthehet aparati nga tregu.

Neni 33
Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e kërkesave të këtij rregulli nga operatorët ekonomikë trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

SHTOJCA I
KËRKESA THELBËSORE

1. Kushtet e përgjithshme

Pajisja projektohet dhe prodhohet në mënyrë që, duke patur parasysh nivelin e zhvillimit teknologjik, të sigurojë që:

a) çrregullimet elektromagnetike të prodhuara prej saj nuk duhet të tejkalojnë nivelin mbi të cilin pajisjet e radios dhe telekomunikacionit ose pajisjet e tjera nuk mund të funksionojnë sipas qëllimit të përcaktuar;

b) të ketë një nivel të mjaftueshëm imuniteti ndaj çrregullimeve elektromagnetike të pritshme në përdorimin e saj sipas qëllimit të përcaktuar, që e lejon atë të funksionojë pa përkeqësim të papranueshëm përdorimin e pajisjes sipas këtij qëllimi.

2. Kërkesa specifike për instalimet e palëvizëshme.

Instalimi dhe përdorimi i synuar i elementeve

Instalimet e palëvizshme instalohen duke aplikuar praktikat më të mira inxhinierike dhe duke respektuar informacionin për përdorimin e parashikuar të elementëve përbërës, me synim plotësimin e kërkesave thelbësore të parashtruar në pikën 1, të kësaj shtojce.

SHTOJCA II
MODULI A: KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT

1. Kontrolli i brendshëm i prodhimit është procedura e vlerësimit të konformitetit sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të kësaj shtojce dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi të plotë që aparati përmbush kërkesat e këtij rregulli teknik të zbatueshëm për të.

2. Vlerësimi i përputhshmërisë elektromagnetike

Prodhuesi bën vlerësimin e pajtueshmërisë elektromagnetike të aparatit në bazë të fenomeneve përkatëse, me qëllim plotësimin e kërkesave thelbësore të parashtruara në pikën 1, të shtojcës I, të kësaj rregullorje.

Vlerësimi i përputhshmërisë elektromagnetike merr parasysh të gjitha kushtet e funksionimit të synuar normal. Nëse aparatet mund të kenë konfigurime të ndryshme, vlerësimi i përputhshmërisë elektromagnetike konfirmon nëse aparatet plotësojnë kërkesat thelbësore të parashtruara në pikën 1, të shtojcës I, të këtij rregulli në të gjitha konfigurimet e mundshme të identifikuara nga prodhuesi si përfaqësues për përdorimin e tij të synuar.

3. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të krijojë dokumentacionin teknik. Dokumentacioni duhet të bëjë të mundur vlerësimin e përputhshmërisë së pajisjes elektrike me kërkesat përkatëse dhe duhet të përfshijë një analizë adekuate dhe vlerësim të riskut.

Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe mbulon, sa i përket vlerësimit, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e aparatit. Dokumentacioni teknik, kur është e zbatueshme, përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të përgjithshëm të aparatit;

b) koncept idenë dhe skicat e skemat e prodhimit të komponenteve, pjesëve të montueshme, qarqeve etj.;

c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për kuptimin e vizatimeve, skemave dhe funksionimin e aparatit;

ç) një listë të standardeve të harmonizuara që zbatohen plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian ose standardet ndërkombëtare ose kombëtare të referuara në pikën 13 të këtij Rregulli dhe, kur këto standarde të harmonizuara ose ndërkombëtare ose standardet kombëtare nuk aplikohen, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për të përmbushur objektivat e sigurisë të kësaj rregulloreje, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike të aplikuara. Në rast të standardeve të harmonizuara të aplikuara pjesërisht ose standardeve ndërkombëtare ose kombëtare të referuara në pikën 13 të kësaj rregulloreje, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë zbatuar;

d) rezultatet e llogaritjes së projektimit që janë bërë, testimet e realizuara etj.;

dh) raportet e testimit.

5. Markimi CE dhe deklarata e EU e konformitetit

5.1 Prodhuesi vendos markimin CE në çdo aparat të veçantë që plotëson kërkesat e zbatueshme për këtë Rregull.

Markimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet CE në formën e mëposhtme:



a) Përmasat e vizatimit të shkallëzuar më lart duhet të respektohen nëse markimi CE zvogëlohet ose zmadhohet,

b) Komponentët e ndryshueshëm të markimit CE duhet të kenë të njëjtën përmasë vertikale, e cila nuk mund të jetë më e vogël se 5 mm.

5.2 Prodhuesi harton një deklaratë me shkrim EU të konformiteti për çdo model aparati dhe e mban atë bashkë me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas vënies në treg të aparatit. Deklarata EU e konformitetit identifikon aparatin për të cilën është hartuar.

Një kopje e deklaratës EU e konformitetit vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse të mbikëqyrjes së tregut sipas kërkesës.

6.Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuar në pikën 5 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të specifikohen në autorizimin përkatës.

SHTOJCA III
PJESA A

Moduli B: Shqyrtimi EC i tipit të aparatit

1. Shqyrtimi EC i tipit të aparatit është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit ku një OM shqyrton projektin teknik të një aparati dhe verifikon e konfirmon që projekti teknik ii aparatit plotëson kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikën 1, të shtojcës I.

2. Shqyrtimi EC i tipit të aparatit kryhet duke vlerësuar përputhshmërinë e projektimit teknik të aparatit me anë të shqyrtimit të dokumentacionit teknik të përmendur në pikën 3, pa ekzaminimin e një mostre (tipi i projektimit). Mund të kufizohet në disa aspekte të kërkesave thelbësore të specifikuara nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

3. Prodhuesi depoziton kërkesën për shqyrtimin EC të tipit të aparatit tek një OM i vetëm i zgjedhur prej tij. Kërkesa specifikon aspektet e kërkesave thelbësore për të cilat kërkohet shqyrtimi dhe përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, edhe emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është depozituar tek asnjë OM tjetër;

c) dokumentacionin teknik. Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë bërjen e vlerësimin të konformitetit të aparatit me kërkesat e zbatueshme të këtij rregulli dhe të përmbajë analizën dhe vlerësimin e duhur të riskut.

Dokumentacioni teknik duhet të të specifikojë kërkesat e zbatueshme dhe të japë informacion për, në masën që është e rëndësishme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e aparatit. Dokumentacioni teknik përmban, kur mundet, të paktën elementet e mëposhtme:

i) një përshkrim të përgjithshëm të aparatit;

ii) koncept idenë dhe skicat dhe skemat e prodhimit të komponentëve, qarqeve, pjesëve të montueshme etj.;

iii) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar skicat dhe skemat si dhe funksionimin e aparatit;

iv) një listë të standardeve të harmonizuara shqiptare që zbatohen plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare dhe nëse nuk janë zbatuar ato standarde të harmonizuara, përshkrimeve të zgjidhjeve të miratuara për të plotësuar kërkesat minimale të kësaj rregulloreje, përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike të zbatueshme. Në rastin e standardeve të harmonizuara që zbatohen pjesërisht, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë zbatuar;

v) rezultatet e llogaritjeve të bëra për projektimin, testet e kryera, etj.;

vi) raportet e testeve.

4. OM shqyrton dokumentacionin teknik për të vlerësuar përputhshmërinë e projektimit teknik të aparatit në lidhje me aspektet e kërkesave thelbësore për të cilat kërkohet shqyrtimi.

5. OM harton një raport vlerësimi që shënon aktivitetet e ndërmarra në përputhje me pikën 4 më sipër dhe rezultatet e tyre. Pa cenuar detyrimet e tij kundrejt ministrit përgjegjës/autoritetit miratues, OM nxjerr raportin, të plotë ose pjesë të tij, vetëm me marrëveshjen e prodhuesit.

6. Në rast se tipi i shqyrtuar plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik, të cilat vlejnë për aparatin në fjalë, OM lëshon për prodhuesin një certifikatë ekzaminimi e tipit EU të aparatit. Certifikata përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, konkluzionet e shqyrtimit, aspektet e kërkesave thelbësore që mbulon shqyrtimi, kushtet (nëse ka) të vlefshmërisë dhe të dhënat e nevojshme për

identifikimin e tipit të miratuar. Certifikata e ekzaminimit të tipit EU duhet të ketë një ose disa shtojca të bashkëngjitura.

Certifikata e ekzaminimit të tipit EU dhe shtojcat e saj përmbajnë të gjithë informacionin e rëndësishëm që mundëson vlerësimin e konformitetit të aparateve të prodhuara me tipin e ekzaminuar dhe kontrollin e tyre pasi janë vënë në përdorim. Nëse tipi nuk i përmbush kërkesat e këtij rregulli teknik, OM refuzon lëshimin e një certifikate e ekzaminimit të tipit EU dhe informon prodhuesin, duke dhënë arsye të detajuara për refuzimin.

7. OM duhet ta mbajë veten të informuar për çdo ndryshim në zhvillimet e mirënjohura teknologjike, që tregon se tipi i miratuar mund të mos i plotësojë më kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje, dhe të përcaktojë nëse këto ndryshime kërkojnë hulumtim të mëtejshëm. Nëse po, OM njofton për këtë prodhuesin.

Prodhuesi njofton OM, që ka dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën e ekzaminimit të tipit EU, për të gjitha modifikimet e bëra në tipin e miratuar që mund të ndikojnë në përputhshmërinë e aparatit me kërkesat thelbësore të këtij Rregulli ose kushtet e vlefshmërisë së asaj certifikate. Modifikime të tilla kërkojnë miratim shtesë në formën e një shtese/shtojce në origjinalin e certifikatës së ekzaminimit të tipit EU të aparatit.

8. Çdo OM njofton ministrin përgjegjës/autoritetin miratues në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të tipit EU të aparatit dhe/ose çdo shtesë të lëshuar apo të hequr dhe vë në dispozicion të ministrit përgjegjës/autoritetit miratues, në mënyrë të rregullt ose sipas kërkesës, listën e certifikatave dhe/ose shtesave të tyre të lëshuara, refuzuara, të pezulluara ose të kufizuara.

Çdo OM informon, vetë dhe sipas kërkesës, OM e tjera në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të tipit EU të aparatit dhe/ose shtesat e tyre të lëshuara, refuzuara, të pezulluara ose të kufizuara.

OM mban një kopje të certifikatës së ekzaminimit të tipit EU të aparatit, shtojcave dhe shtesave e saj, si dhe dosjet teknike, përfshirë dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi, deri në mbarimin e vlefshmërisë të asaj certifikate.

9. Prodhuesi mban një kopje të certifikatës së ekzaminimit të tipit EU të aparatit, shtojcave dhe shtesave e saj, si dhe dosjet teknike, në dispozicion strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për 10 vjet pas vendosjes në treg të aparatit.

10. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të depozitojë kërkesën e përmendur në pikën 3 dhe të përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikën 7 dhe 9 nëse ato janë të specifikuara në aktin e tij të përfaqësimit.

PJESA B

Moduli C: konformiteti me llojin e bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit

1.Konformiteti me llojin e bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit sipas të cilit prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 dhe siguron dhe deklaron se aparatet në fjalë janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipit EU dhe plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik që zbatohet për të.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë konformitetin e aparateve të prodhuara me tipin e miratuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipit EU dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik që zbatohet për to.

3. Markimi i konformitetit dhe deklaratës EU së konformitetit

3.1. Prodhuesi vendos markimin CE në çdo aparat të veçantë që është në përputhje me llojin e përshkruar në çertifikatën e ekzaminimit të tipit në BE dhe përmbush kërkesat e zbatueshme për këtë Rregull.

3.2. Prodhuesi harton një deklaratë me shkrim të konformitetit të BE-së për çdo model aparati dhe mban në dispozicion të strukturave të mbikëqyrjes së tregut për 10 vjet pas vendosjes

në treg të aparatit. Deklarata EU e konformitetit identifikon modelin pajisës për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës EU së konformitetit është në dispozicion të autoriteteve përkatëse me kërkesë.

4. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuar në pikën 3 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nëse ato janë të specifikuara në aktin e tij të përfaqësimit.

SHTOJCA IV
DEKLARATA EU KONFORMITETIT (Nr XXXX) (1)

1.Modeli i aparatit (produkti, tipi, numri serial):

2.Emri dhe adresa e prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar:

3.Kjo deklaratë e konformitetit lëshohet nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit.

4.Objekti i deklaratës (identifikimi i aparatit që lejon gjurmueshmërinë e tij, nëse është e nevojshme mund të përmbajë një imazh me ngjyra dhe mjaftueshmërisht të qartë për identifikimin e aparatit):

5.Objekti i deklaratës së përshkruar më sipër është në përputhje me legjislacionin në fuqi të fushës:

6.Referencat e përdorura për standardet përkatëse të harmonizuara ose referencat ndaj specifikimeve të tjera teknike në lidhje me të cilat është deklaruar konformiteti:

7.Kur është e mundur, organi i miratuar ... (emri, numri) realizon.... (përshkrim të ndërhyrjes) dhe lëshon certifikatën:

8.Informacion shtesë:

nënshkruar për dhe në emër të:

(vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni) (nënshkrimi):

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA
Direktiva - 2014/30/EU- Përputhshmëria elektromagnetike

NR.	**Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar (dhe dokumenti i referencës)**	**Titulli i standardit në shqip**	**Viti i adoptimi t si SSH**	**Mënyra e adoptimi t** (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
	EN 617:2001+A1:2010 Continuous handling equipment and systems - Safety and EMC requirements for the equipment for the storage of bulk materials in silos, bunkers, bins and hoppers	SSH EN 617:2001+A1:2010 Pajisje dhe sistemet të furnizimit të vazhdueshëm - Kërkesat e sigurisë dhe të përputhshmërisë elektromagnetike për pajisjet e ruajtjes së materialit rifuzo në silo, bunkerë, kova dhe hinka	2011	Fp
	EN 618:2002+A1:2010	SSH EN 618:2002+A1:2010	2011	Fp

	Continuous handling equipment and systems - Safety and EMC requirements for equipment for mechanical handling of bulk materials except fixed belt conveyors	Pajisjet dhe sistemet për transportimin e vazhdueshëm - Kërkesat për sigurinë dhe kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike për pajisjet për transportimin mekanik të materialeve rifuzo, përveç konvejerëve me shirit të fiksuar		
	EN 619:2002+A1:2010 Continuous handling equipment and systems - Safety and EMC requirements for equipment for mechanical handling of unit loads	SSH EN 619:2002+A1:2010 Pajisjet dhe sistemet për transportimin e vazhdueshëm - Kërkesat për sigurinë dhe kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike për pajisjet për transportimin mekanik të ngarkesave njësi	2011	Fp
	EN 620:2002+A1:2010 Continuous handling equipment and systems - Safety and EMC requirements for fixed belt conveyors for bulk materials	SSH EN 620:2002+A1:2010 Pajisjet dhe sistemet për transportimin e vazhdueshëm - Kërkesat për sigurinë dhe kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike për konvejerët me shirit të fiksuar për transportimin e materialit rifuzo	2011	Fp
	EN 1155:1997 Building hardware - Electrically powered hold-open devices for swing doors - Requirements and test methods	SSH EN 1155:1997 Aksesorë, (brava, shula, reze etj.) për ndërtesat - Pajisjet elektrike të mbajtjes hapur për dyert rrotulluese - Kërkesat dhe metodat e provës	2005	Fp
	EN 1155:1997/A1:2002	SSH EN 1155:1997/A1:2002	2005	Fp
	EN 12015:2014 Electromagnetic compatibility - Product family standard for lifts, escalators and moving walks - Emission	SSH EN 12015:2014 Përputhshmëria elektromagnetike - Standarde të familjes së produkteve për ashensorët, shkallët lëvizëse dhe konvejerët për pasagjerë - Emetimi	2014	Fp
	EN 12016:2013 Electromagnetic compatibility - Product family standard for lifts, escalators and moving walks - Immunity	SSH EN 12016:2013 Kompatibiliteti elektromagnetik - Standarde të familjes së produkteve për ashensorët, shkallët lëvizëse dhe vendkalimet	2014	Fp

		lëvizëse - Imuniteti		
	EN 12895:2015 Industrial trucks - Electromagnetic compatibility	SSH EN 12895:2015 Kamionë industriale - Përputhshmëria elektromagnetike	2016	Fp
	EN 13241-1:2003+A1:2011 Industrial, commercial and garage doors and gates - Product standard - Part 1: Products without fire resistance or smoke control characteristics	SSH EN 13241-1:2003+A1:2011 Dyer dhe porta industriale, tregtare dhe të garazheve - Standard produkti - Pjesa 1: Produkte pa rezistencë ndaj zjarrit ose karakteristikat e kontrollit të tymit	2012	Fp
	EN 13309:2010 Construction machinery - Electromagnetic compatibility of machines with internal power supply	SSH EN 13309:2010 Makineritë e ndërtimit - Përputhshmëria elektromagnetike e makinave me furnizim të brendshëm të energjisë elektrike	2011	Fp
2.	EN 14010:2003+A1:2009 Safety of machinery - Equipment for power driven parking of motor vehicles - Safety and EMC requirements for design, manufacturing, erection and commissioning stages	SSH EN 14010:2003+A1:2009 Siguria e makinerisë - Pajisje për parkimin e motorizuar të automjeteve - Siguria dhe kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike për projektimin, prodhimin, montimin dhe vënien në punë	2006	Fp
	EN ISO 14982:2009 Agricultural and forestry machinery - Electromagnetic compatibility - Test methods and acceptance criteria (ISO 14982:1998)	SSH EN ISO 14982:2009 Makineritë bujqësorë dhe për pyjet - Përputhshmëria elektromagnetike - Metodat e provave dhe kriteret e pranimit	2009	Fp
	EN 16361:2013+A1:2016 Power operated pedestrian doors - Product standard, performance characteristics - Pedestrian doorsets, other than swing type, initially designed for installation with power operation without resistance to fire and smoke leakage characteristics	SSH EN 16361:2013+A1:2016 Dyer të motorizuara për këmbësor - Standardet e produktit, karakteristikat e performancës - Kompletet e dyerve për këmbësor, me ritëm të ndryshëm, fillimisht të dizenjuara për t'u montuar të motorizuara pa karakteristikat e rezistencës nga zjarri dhe rrjedhjes së tymit	2017	Fp

	EN 50065-1:2011 Signalling on low-voltage electrical installations in the frequency range 3 kHz to 148,5 kHz - Part 1: General requirements, frequency bands and electromagnetic disturbances	SSH EN 50065-1:2011 Transmetimi i sinjalit në instalimet elektrike me tension të ulët në diapazonin e frekuencave 3 kHz deri 148.5 kHz - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme, bandat e frekuencës dhe çrregullimet elektromagnetike	2013	Fp
	EN 50065-2-1:2003 Signalling on low-voltage electrical installations in the frequency range 3 kHz to 148,5 kHz - Part 2-1: Immunity requirements for mains communications equipment and systems operating in the range of frequencies 95 kHz to 148,5 kHz and intended for use in residential, commercial and light industrial environments	SSH EN 50065-2-1:2003 Specifikime për sinjalizimin në instalimet elektrike me tension të ulët në diapazonin e frekuencave 3 kHz deri 148,5 kHz - Pjesa 2-1: Kërkesat për imunitetin për aparatet dhe për sistemet e komunikimit në rrjetin elektrik, që punojnë në bandën e frekuencave nga 95 kHz deri 148,5 kHz dhe që parashikohen të përdoren në mjediset rezidenciale, tregtare dhe të industrisë së lehtë	2007	Fp
	EN 50065-2-1:2003/A1:2005	SSH EN 50065-2-1:2003/A1:2005		Fp
	EN 50065-2-1:2003/AC:2003	SSH EN 50065-2-1:2003/AC:2003	2011	Fp
	EN 50065-2-2:2003 Signalling on low-voltage electrical installations in the frequency range 3 kHz to 148,5 kHz - Part 2-2: Immunity requirements for mains communications equipment and systems operating in the range of frequencies 95 kHz to 148,5 kHz and intended for use in industrial environments	SSH EN 50065-2-2:2003 Specifikime për sinjalizimin në instalimet elektrike me tension të ulët në diapazonin e frekuencave 3 kHz deri 148,5 kHz - Pjesa 2-2: Kërkesa për imunitetin për aparatet dhe për sistemet e komunikimit në rrjetin elektrik, që punojnë në bandën e frekuencave nga 95 kHz deri 148,5 kHz dhe që parashikohen të përdoren në mjediset industriale	2007	Fp
	EN 50065-2-2:2003/AC:2003	SSH EN 50065-2-2:2003/A1:2005		Fp
	EN 50065-2-2:2003/A1:2005/AC:2006	SSH EN 50065-2-2:2003/AC:2003	2011	Fp
	EN 50065-2-2:2003/A1:2005	SSH EN 50065-2-2:2003/A1:2005/AC:2006	2013	Fp

	EN 50065-2-3:2003 Signalling on low-voltage electrical installations in the frequency range 3 kHz to 148,5 kHz - Part 2-3: Immunity requirements for mains communications equipment and systems operating in the range of frequencies 3 kHz to 95 kHz and intended for use by electricity suppliers and distributors	SSH EN 50065-2-3:2003 Specifikime për sinjalizimin në instalimet elektrike me tension të ulët në diapazonin e frekuencave 3 kHz deri 148,5 kHz - Pjesa 2-3: Kërkesa për imunitetin për aparatet dhe për sistemet e komunikimit në rrjetin elektrik, që punojnë në bandën e frekuencave nga 95 kHz deri 148,5 kHz dhe që parashikohen të përdoren nga furnizuesit dhe shpërndarësit e energjisë elektrike	2007	Fp
	EN 50065-2-3:2003/AC:2003	SSH EN 50065-2-3:2003/A1:2005		Fp
	EN 50065-2-3:2003/A1:2005	SSH EN 50065-2-3:2003/AC:2003	2011	Fp
	EN 50083-2:2012 Cable networks for television signals, sound signals and interactive services - Part 2: Electromagnetic compatibility for equipment	SSH EN 50083-2:2012 Rrjete kabllore për sinjalet televizive, sinjalet e zërit dhe shërbimet interaktive - Pjesa 2: Pajtueshmëria elektromagnetike për pajisjet	2013	Fp
	EN 50083-2:2012/A1:2015	SSH EN 50083-2:2012/A1:2015	2018	Fp
	EN 50121-1:2006 Railway applications - Electromagnetic compatibility - Part 1: General	SSH EN 50121-1:2006 Përdorime hekurudhore - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 1: Të përgjithshme	2008	Fp
	EN 50121-1:2006/AC:2008	SSH EN 50121-1:2006/AC:2008	2011	Fp
	EN 50121-2:2006 Railway applications - Electromagnetic compatibility - Part 2: Emission of the whole railway system to the outside world	SSH EN 50121-2:2006 Përdorime hekurudhore - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 2: Emetimi i sistemit të plotë hekurudhor në mjedisin e jashtëm	2008	Fp
	EN 50121-2:2006/AC:2008	SSH EN 50121-2:2006/AC:2008	2011	Fp
	EN 50121-3-1:2017 Railway applications - Electromagnetic compatibility -	SSH EN 50121-3-1:2017 Zbatime në hekurudhë - Përputhshmëria	2017	Fp

	Part 3-1: Rolling stock - Train and complete vehicle	elektromagnetike - Pjesa 3-1: Mjeti hekurudhor - Treni dhe automjeti komplet		
	EN 50121-3-2:2016 Railway applications - Electromagnetic compatibility - Part 3-2: Rolling stock - Apparatus	SSH EN 50121-3-2:2016 Zbatime në hekurudhë - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 3-2: Mjeti hekurudhor - Aparaturat	2017	Fp
	EN 50121-4:2066 Railway applications - Electromagnetic compatibility - Part 4: Emission and immunity of the signalling and telecommunications apparatus	SSH EN 50121-4:2016 Zbatime në hekurudhë - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 4: Emetimi dhe imuniteti i aparateve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit	2017	Fp
	EN 50121-5:2017 Railway applications - Electromagnetic compatibility - Part 5: Emission and immunity of fixed power supply installations and apparatus	SSH EN 50121-5:2017 Zbatime në hekurudhë - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 5: Emetimi dhe imuniteti i aparateve dhe instalimeve fikse të furnizimit me energji	2017	Fp
	EN 50130-4:2011 Alarm systems - Part 4: Electromagnetic compatibility - Product family standard: Immunity requirements for components of fire, intruder, hold up, CCTV, access control and social alarm systems	SSH EN 50130-4:2011 Sistemet e alarmit - Pjesa 4: Përputhshmëria elektromagnetike - Standardi i familjes së produktit: Kërkesat e imunitetit për komponentët e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrësi, vjedhja, CCTV, për kontrollin e hyrjes dhe sistemet sociale të alarmit	2011	Fp
	EN 50148:1995 Electronic taximeters	SSH EN 50148:1995 Taksimetri elektronik	2008	Fp
	EN 50270:2015 Electromagnetic compatibility - Electrical apparatus for the detection and measurement of combustible gases, toxic gases or oxygen	SSH EN 50270:2015 Përputhshmëria elektromagnetike - Aparate elektrike për zbulimin dhe matjen e gazrave të djegshëm, të gazrave helmuese ose të oksigjenit	2015	Fp
	EN 50270:2015/AC:2016-08	SSH EN 50270:2015/AC:2016	2017	Fp

	EN 50293:2012 Road traffic signal systems - Electromagnetic compatibility	SSH EN 50293:2012 Sistemet e sinjalizimit të trafikut rrugor - Përputhshmëria elektromagnetike	2013	Fp
	EN 50370-1:2005 Electromagnetic compatibility (EMC) - Product family standard for machine tools - Part 1: Emission	SSH EN 50370-1:2005 Përputhshmëria elektromagnetike - Standardi i familjes së produktit për veglat e makinerisë - Pjesa 1: Emetimi	2008	Fp
	EN 50370-2:2003 Electromagnetic compatibility (EMC) - Product family standard for machine tools - Part 2: Immunity	SSH EN 50370-2:2003 Përputhshmëria elektromagnetike - Standardi i familjes së produktit për veglat e makinerisë - Pjesa 2: Imuniteti	2008	Fp
	EN 50412-2-1:2005 Power line communication apparatus and systems used in low-voltage installations in the frequency range 1,6 MHz to 30 MHz - Part 2-1: Residential, commercial and industrial environment - Immunity requirements	SSH EN 50412-2-1:2005 Sistemet dhe aparatet e linjave të komunikimit të fuqisë të përdorura në instalimet e tensionit të ulët në diapazonin e frekuencave 1,6 MHz deri në 30 MHz - Pjesa 2-1: Ambientet rezidenciale, tregtare dhe industriale - Kërkesat e imunitetit	2008	Fp
	EN 50412-2-1:2005/AC:2009	SSH EN 50412-2-1:2005/AC:2009	2011	Fp
	EN 50428:2005 Switches for household and similar fixed electrical installations - Collateral standard - Switches and related accessories for use in home and building electronic systems (HBES)	SSH EN 50428:2005 Çelësat për instalimet elektrike të fiksuara shtëpiake dhe pajisje të ngjashme me to - Standard shtesë - Çelësat dhe aksesorët e ngjashme me to për përdorim në sistemet elektronike të shtëpive dhe ndërtesave	2008	Fp
	EN 50428:2005/A2:2009	SSH EN 50428:2005/A1:2007		Fp
	EN 50428:2005/A1:2007	SSH EN 50428: 2005/A2:2009	2009	Fp
	EN 50470-1:2006 Electricity metering equipment (a.c.) - Part 1: General requirements, tests and test conditions - Metering	SSH EN 50470-1:2006 Pajisje të matjes së elektricitetit(a.c) - Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme, provat dhe kushtet e provave - Pajisjet	2008	Fp

	equipment (class indexes A, B and C)	matëse (Indekset e klasës A,B, dhe C)		
	EN 50490:2008 Electrical installations for lighting and beaconing of aerodromes - Technical requirements for aeronautical ground lighting control and monitoring systems - Units for selective switching and monitoring of individual lamps	SSH EN 50490:2008 Instalime elektrike për ndriçimin dhe sinjalizimin e aerodromeve - Kërkesat teknike për sistemet e kontrollit dhe monitorimit të ndriçimit tokësor aeronautik - Njësitë për ç'kyçjen përzgjedhëse dhe monitorimin e llambave individuale	2010	Fp
	EN 50491-5-1:2010 General requirements for Home and Building Electronic Systems (HBES) and Building Automation and Control Systems (BACS) - Part 5-1: EMC requirements, conditions and test set-up	SSH EN 50491-5-1:2010 Kërkesa të përgjithshme për Sisteme Elektronike të Ndërtesave dhe Banesave (HBES) dhe Sisteme të Automatizimit dhe Kontrollit të Ndërtesave (BACS) - Pjesa 5-1: Kërkesa EMC, kushte dhe ndërtimi i provës	2011	Fp
	EN 50491-5-2:2010 General requirements for Home and Building Electronic Systems (HBES) and Building Automation and Control Systems (BACS) - Part 5-2: EMC requirements for HBES/BACS used in residential, commercial and light industry environment	SSH EN 50491-5-2:2010 Kërkesa të përgjithshme për Sisteme Elektronike të Ndërtesave dhe Banesave (HBES) dhe Sisteme të Automatizimit dhe Kontrollit të Ndërtesave (BACS) - Pjesa 5-2: Kërkesa EMC për HBES/BACS të përdorura në ambiente rezidenciale, tregtare dhe të industrisë së lehtë	2011	Fp
	EN 50491-5-3:2010 General requirements for Home and Building Electronic Systems (HBES) and Building Automation and Control Systems (BACS) - Part 5-3: EMC requirements for HBES/BACS used in industry environment	SSH EN 50491-5-3:2010 Kërkesa të përgjithshme për Sisteme Elektronike të Ndërtesave dhe Banesave (HBES) dhe Sisteme të Automatizimit dhe Kontrollit të Ndërtesave (BACS) - Pjesa 5-3: Kërkesa EMC për HBES/BACS të përdorura në ambiente të industrisë	2011	Fp
	EN 50498:2010 Electromagnetic compatibility (EMC) - Product family	SSH EN 50498:2010 Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC) – Standard i familjes së	2011	Fp

	standard for aftermarket electronic equipment in vehicles	produkteve për përdorim si pjesë këmbimi në pajisjet elektronike në automjete		
	EN 50512:2009 Electrical installations for lighting and beaconing of aerodromes - Advanced Visual Docking Guidance Systems (A-VDGS)	SSH EN 50512:2009 Instalime elektrike për ndriçimin dhe sinjalizimin e aerodromeve - Sistemet vizuale të avancuara për udhëzimin e uljes (A-VDGS)	2011	Fp
	EN 50529-1:2010 EMC Network Standard - Part 1: Wire-line telecommunications networks using telephone wires	SSH EN 50529-1:2010 Standard i rrjetave EMC – Pjesa 1: Rrjetat e telekomunikacionit që përdorin linja telefonike	2011	Fp
	EN 50529-2:2010 EMC Network Standard - Part 2: Wire-line telecommunications networks using coaxial cables	SSH EN 50529-2:2010 Standard i rrjetave EMC – Pjesa 2: Rrjetat e telekomunikacionit që përdorin kabllo koaksialë	2011	Fp
	EN 50550:2011 Power frequency overvoltage protective device for household and similar applications (POP)	SSH EN 50550:2011 Pajisjet mbrojtëse kundër mbitensionit me frekuencë industriale për përdorime shtëpiake dhe të ngjashme me to	2012	Fp
	EN 50550:2011/A1:2014	SSH EN 50550:2011/A1:2014	2015	Fp
	EN 50550:2011/AC:2012	SSH EN 50550:2011/AC:2012	2012	Fp
	EN 50557:2011 Requirements for automatic reclosing devices (ARDs) for circuit breakers-RCBOs-RCCBs for household and similar uses	SSH EN 50557:2011 Kërkesat për pajisjet për rimbylljen automatike (ARDs) për ndërprerësit e qarkut RCBO-RCCB për përdorime shtëpiake dhe të ngjashme me to	2013	Fp
	EN 50561-1:2013 Power line communication apparatus used in low-voltage installations - Radio disturbance characteristics - Limits and methods of measurement - Part 1: Apparatus for in-home use	SSH EN 50561-1:2013 Aparatet e komunikimit të linjave të transmetimit të përdorura në instalimet me tension të ulët - Karakteristikat e radio zhurmave - Limitet dhe metodat e matjes - Pjesa 1: Aparatet për përdorim në ambientet e shtëpisë	2014	Fp
	EN 55011:2009	SSH EN 55011:2009	2010	Fp

	Industrial, scientific and medical equipment - Radio-frequency disturbance characteristics - Limits and methods of measurement	Pajisje industriale, shkencore dhe mjekësore - Karakteristikat e çrregullimeve radioelektrike - Limitet dhe metodat e matjes		
	EN 55011:2009/A1:2010	SSH EN 55011:2009/A1:2010	2011	Fp
	EN 55012:2007 Vehicles, boats and internal combustion engines - Radio disturbance characteristics - Limits and methods of measurement for the protection of off-board receivers	SSH EN 55012:2007 Automjetet, anijet dhe pajisjet me motor me djegie të brendshme - Karakteristikat e çrregullimeve radioelektrike - Limitet dhe metodat e matjes për mbrojtjen e marrësve të jashtëm	2008	Fp
	EN 55012:2007/A1:2009	SSH EN 55012:2007/A1:2009	2010	Fp
	EN 55014-1:2006 Electromagnetic compatibility - Requirements for household appliances, electric tools and similar apparatus - Part 1: Emission	SSH EN 55014-1:2006 Përputhshmëria elektromagnetike - Kërkesat për pajisjet elektroshtëpiake, për veglat elektrike dhe për aparatet e ngjashme - Pjesa 1: Emetimi	2007	Fp
	EN 55014-1:2006/A1:2009	SSH EN 55014-1:2006/A1:2009	2009	Fp
	EN 55014-1:2006/A2:2011	SSH EN 55014-1:2006/A2:2011	2013	Fp
	EN 55014-2:1997 Electromagnetic compatibility - Requirements for household appliances, electric tools and similar apparatus - Part 2: Immunity - Product family standard	SSH EN 55014-2:1997 Përputhshmëria elektromagnetike - Kërkesat për pajisjet elektroshtëpiake, për veglat elektrike dhe për aparatet e ngjashme - Pjesa 2: Imuniteti - Standard i familjes së produktit	2004	Fp
